



Mesazhe nga nxënësit:

- Askush s'mund të të sjellë paqe veç ti vetes
- Njerëzit e lirë për të zgjedhur gjithmonë do të zgjedhin paqen
- Paqja fillon me një buzëqeshje
- Urrejtja nuk mund ta dëbojë urrejtjen vetëm dashuria mund ta bëjë këtë
- Paqja është dhurata jonë për njeri tjetrin



Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
Blv. "Bajram Curri", Nd. 136, H.14, Ap. nr.1, TIRANE

Email: info@observator.org.al

Web: www.observator.org.al, Tel. 00355 42 258 987



Ky projekt financohet nga Bashkimi Evropian



FAMILJA, SHKOLLA DHE KOMUNITETI SË BASHKU PËR BASHKËJETESË, HARMONI DHE PAQE SOCIALE



Shkollat si kundërshtarë të vijës së parë të ekstremizmit të dhunshëm

Ky botim është prodhuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përbajtja e tij është përgjegjësi e Observatorit për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

“Shkollat si kundërshtarë të vijës së parë të ekstremizmit të dhunshëm”.

Është një nismë që po zbaton Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve.

Zonat e zbatimit: Kamëz, Elbasan dhe Pogradec

Periudha: Shkurt-Nëntor 2018

Qëllimi: Parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm duke angazhuar shkollat si një institucion kryesor i vijës së frontit.

Pse është zgjedhur shkolla:

Sepse shkolla është institucion arsimor ku të rinjtë edukohen dhe formojnë konceptet si dhe mund të luajë rolin e koordinatores me institucionet lokale dhe komunitetin për parandalimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm.

Çfarë synohet të arrihet:

- ◆ Krijimi i një pakete me tema për ekstremizmin e dhunshëm e cila të bëhet pjesë e programit të edukimit qytetar për nxënësit e shkollave të mesme.
- ◆ Rritja e kapaciteteve të shkollave për t'u angazhuar në përballimin e ekstremizmit të dhunshëm.
- ◆ Formimi i konceptit kundër ekstremizmit të dhunshëm për 600 nxënës të shkollës dhe pjesëtarë të komunitetit nëpërmjet realizimit të debateve publike.
- ◆ Promovimi i tolerancës, paqes dhe respektimi i të drejtave të njeriut.
- ◆ Forcimi i trekëndëshit shkollë-familje-shoqëri.
- ◆ Realizim i një fushate ndërgjegjësuese dhe sensibilizuese me pjesëmarrjen e nxënësve të shkollave dhe komunitetit në të tre zonat pilot të shtrirjes së projektit.

Përkufizime

1

Çfarë është ekstremizmi?

“Kur një person apo grup personash ka mendime të cilat për shumicën e njerezvë janë të paarësyeshme dhe të papranueshme”.

(Trajnimi QKED “Me shkollat për komunitete të sigurta”, 2017)

Ai mund të jetë:

- ✓ Politik
- ✓ Fetar
- ✓ Fanatizëm
- ✓ Racor

2

Çfarë janë sjelljet anti-shoqërore?

“Çdo sjellje e papranueshme e cila përbën rrezik për mirëqenien e nxënësve dhe/ose sigurinë në shkollë”

(Trajnimi QKED “Me shkollat për komunitete të sigurta”, 2017)

Sjellje të tilla mund të jenë:

- ✓ Bulizmi
- ✓ Ngacmimi
- ✓ Diskriminimi kundrejt nxënësve të tjerë mbi bazën e racës, gjinisë, fesë etj

3

Çfarë është Toleranca:

Tolerancë është pranimi i faktit se “qeniet njerëzore janë natyrshëm të ndryshëm për nga pamja, pozita, të folurit, sjelljet dhe vlerat, kanë të drejtë të jetojnë dhe të jenë ashtu siç janë” *(Sipas Deklaratës së OKB-së)*